



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 20, Datë 18.02.2019**

**MBI**

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 245, DATË 26.11.2018, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “RENRGY TRADING GROUP” SH.P.K NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2 gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 104, pika 4 gërma a, dhe nenit 113 të Ligjit 44/2015 “Kodi i procedurës Administrative”, nenit 4, pika 1, gërma “d”; nenit 5, pika 1 gërma “d”; nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 18.02.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi “Plotësimin e kushtit të vendosur në vendimin nr. 245, datë 26.11.2018, “për licencimin e shoqërisë “Renrgy trading group” sh.p.k në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE me vendimin nr. 245, datë 26.11.2018, ka vendosur si më poshtë:
  1. Të licencojë shoqërinë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar,
  2. Shoqëria brenda 3 muajve nga marrja dijani e këtij vendimi, të depozitojë në ERE strukturën e ndërtimit të shoqërisë.
  3. Shoqëria përpara se të fillojë operimin në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike të njoftojë ERE-n mbi implementimin e sistemit të platformës IT që do të përdori.
  4. Në rastin e mospërbushjes së këtyre kushteve nga ana e subjektit, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi.

- Shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 107, datë 01.02.2019 dhe nr. 107/1, datë 08.02.2019, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:
  - Organigramën dhe Listën e personelit të shoqërisë sipas profilit, të nënshkruara nga administratori,
  - Marrëveshjen e datës 09.01.2019, për shërbimin e sistemit IT, me subjektin “Novita d.o.o”.
- Sa më sipër, rezulton se shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., ka plotësuar kushtin e vendosur në vendimin e Bordit të ERE nr. 245, datë 26.11.2018.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e bordit të ERE nr. 245, datë 26.11.2018, “Për licencimin e shoqërisë “Renrgy trading group” sh.p.k në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”
2. Pikat 2, 3 dhe 4 të vendimit të bordit të ERE nr. 245, datë 26.11.2018, “Për licencimin e shoqërisë “Renrgy trading group” sh.p.k në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, shfuqizohen.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË**

**Adriatik BEGO**